



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.2992/6 prot

Datë 12.12.2023

V E N D I M
Nr. 1284/2023

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 12.12.2023, shqyrtoi çështjen me:

Objekt:

Vendim për mbylljen e çështjes mbi ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “TETRA” SHPK në procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur e thjeshtuar” me nr. REF – 86468-11-06-2023, me objekt: “Shërbim mirëmbajtje karikues elektrik, Marrëveshje kuadër për 2 vite”, me fond limit 9,000,000 (nëntë milion) lekë (pa TVSh), zhvilluar me datë 17.11.2023 nga autoriteti kontraktor, Posta Shqiptare Sh.A.

Ankimues:

“TETRA” SHPK me NIPT K72017027P dhe adresë, Rruga “Gjin Bue Shpata”, P.2/1, Ap.2, Nj.Bashkiake nr.5, Tiranë.

Autoriteti Kontraktor:

Posta Shqiptare Sh.A. me adresë Rruga “Reshit Çollaku” Nr. 4, Tiranë.

Baza Ligjore:

Nenet 30 dhe 115 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, i

Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi informacionin e paraqitur

Vëren:

I

Vlerësimi Paraprak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga 3 anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 07.11.2023 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “Procedurë e hapur e thjeshtuar” me nr. REF – 86468-11-06-2023, me objekt: “Shërbim mirëmbajtje karikues elektrik, Marrëveshje kuadër për 2 vite”, me fond limit 9,000,000 (nëntë milion) lekë (pa TVSh), zhvilluar me datë 17.11.2023 nga autoriteti kontraktor, Posta Shqiptare Sh.A.

II.2. Në datën 01.12.2023 pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me numër ankimi elektronik A/2023/3663 dhe me nr. 2992/2023 prot., datë 01.12.2023 dhe e protokolluar njëkohësisht edhe pranë autoritetit kontraktor Posta Shqiptare Sh.A. me datë 01.12.2023, e operatorit ekonomik “TETRA” SHPK. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se objekti i saj lidhet me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të

Ofertave, mbi skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “TETRA” SHPK nga procedura e prokurimit të sipërcituar.

II.3. Bazuar në nenin 112, pika 4, gërma “b” të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: “Në mënyrë që ankesa të bëhet e aksesueshme jo vetëm nga autoriteti ose enti kontraktor, por njëkohësisht edhe nga operatorët ekonomikë të interesuar, KPP-ja publikon: b) arsyet e skualifikimit në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar;”, Komisioni i Prokurimit Publik do të publikojë arsyet e skualifikimit të operatorit ekonomik “TETRA” SHPK.

II.4. Me anë të shkresës nr. 2182/8 prot., datë 07.12.2023 me objekt “Informacion mbi procedurën e prokurimit me objekt “Shërbim mirëmbajtje karikues elektrik, Marrëveshje kuadër për 2 vite””, autoriteti kontraktor ka dorëzuar informacion mbi trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues, me nr. 2182/7 prot., datë 07.12.2023. Konkretisht, referuar shkresës së mësipërme, konstatohet, se autoriteti kontraktor ka vendosur pranim plotësisht të ankesës si më poshtë vijon:

[...]

....Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës, në zbatim të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, dokumenteve standarde të tenderit si dhe të urdhrin të administratorit të shoqërisë, ju informon se nga ana jonë u kryen verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike të dokumentacionit të paraqitur nga ana juaj, ku rezulton se në përpmbushje të kriterit 2.3.1 keni paraqitur kontratën me objekt “Blerje karikues makinash elektrike” nr. 2240/10 prot., datë 18.01.2021, me autoritet kontraktor Posta Shqiptare ShA. Në përpmbushje të këtij kriteri gjithashtu rezulton se nga ana juaj është paraqitur edhe vërtetimi për realizim kontrate me sukses lëshuar nga autoriteti kontraktor Posta Shqiptare ShA, me nr. 1914/1 prot., datë 20.09.2022, përpmbushur plotësisht në përputhje me kontratën, duke përfshirë edhe mirëmbajtjen për periudhën njëvjeçare, të garancisë teknike të instalimit dhe implementimit, të mallit karikues elektrik. Në përpmbushje të kapacitetit ekonomik të DST për pikën 2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar, rezulton se është paraqitur në SPE vërtetim i lëshuar nga administrata tatimore për xhiron e tre viteve të fundit në një masë e cila e tejkalon kërkesën e objekt - kontrate, gjithashtu dokumentacioni është i shoqëruar edhe me vërtetime nga ana e prodhuesit të mallrave objekt - procedure si dhe certifikatat për trajnimin e specializuar të stafit, duke përpmbushur kërkesat ligjore për kualifikim. Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 90 e në vijim të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” si dhe dokumenteve standarde të tenderit, u konstatua se oferta e paraqitur nga operatori ekonomik “TETRA” SHPK, është në përputhje me kërkesat e tenderit. Për sa më sipër, pretendimi juaj vlerësohet i drejtë. Në analizë të sa më sipër, autoriteti ynë kontraktor vlerëson se operatori ankimues “TETRA” SHPK e përpmbush plotësisht kriterin e parashikuar në pikën 2.3.1 të kriterëve të veçanta për kualifikim, kapaciteti teknik të shtojca 8, të DST-së dhe pretendimet vlerësohen të drejta. Në përfundim të shqyrtimit të ankesës së operatorit ankimues “TETRA” SHPK në mbështetje dhe zbatim të pikës 3/a të nenit 114, të ligjit nr 162/2020 dhe pika 1/a të nenit 102 të VKM nr.285/2021, vendos pranimin e plotë të ankesës së operatorit ankimues “TETRA” SHPK duke e vlerësuar ofertë të rregullt.”

Komisioni i Prokurimit Publik, pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj si dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

Arsyeton:

III.1. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues mbi kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, mbi skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “TETRA” SHPK nga procedura e prokurimit të sipërcituar, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1. Me anë të shkresës nr. 2182/8 prot., datë 07.12.2023 me objekt “*Informacion mbi procedurën e prokurimit me objekt “Shërbim mirëmbajtje karikues elektrik, Marrëveshje kuadër për 2 vite”*”, autoriteti kontraktor ka dorëzuar informacion mbi trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues, me nr. 2182/7 prot., datë 07.12.2023. Konkretisht, referuar shkresës së mësipërme, konstatohet, se autoriteti kontraktor ka vendosur pranim plotësisht të ankesës si më poshtë vijon:

[...]

....Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës, në zbatim të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, dokumenteve standarde të tenderit si dhe të urdhrat të administratorit të shoqërisë, ju informon se nga ana jonë u kryen verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike të dokumentacionit të paraqitur nga ana juaj, ku rezulton se në përmbushje të kriterit 2.3.1 keni paraqitur kontratën me objekt “Blerje karikues makinash elektrike” nr. 2240/10 prot., datë 18.01.2021, me autoritet kontraktor Posta Shqiptare ShA. Në përmbushje të këtij kriteri gjithashtu rezulton se nga ana juaj është paraqitur edhe vërtetimi për realizim kontrate me sukses lëshuar nga autoriteti kontraktor Posta Shqiptare ShA, me nr. 1914/1 prot., datë 20.09.2022, përmbushur plotësisht në përputhje me kontratën, duke përfshirë edhe mirëmbajtjen për periudhën njëvjeçare, të garancisë teknike të instalimit dhe implementimit, të mallit karikues elektrik. Në përmbushje të kapacitetit ekonomik të DST për pikën 2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar, rezulton se është paraqitur në SPE vërtetim i lëshuar nga administrata tatimore për xhiron e tre viteve të fundit në një masë e cila e tejkalon kërkesën e objekt - kontrate, gjithashtu dokumentacioni është i shoqëruar edhe me vërtetime nga ana e prodhuesit të mallrave objekt - procedure si dhe certifikatat për trajnimin e specializuar të stafit, duke përmbushur kërkesat ligjore për kualifikim. Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 90 e në vijim të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” si dhe dokumenteve standarde të tenderit, u konstatua se oferta e paraqitur nga operatori ekonomik “TETRA” SHPK, është në përputhje me kërkesat e tenderit. Për sa më sipër, pretendimi juaj vlerësohet i drejtë. Në analizë të sa më sipër, autoriteti ynë kontraktor vlerëson se operatori ankimues “TETRA” SHPK e përmbush plotësisht kriterin e parashikuar në pikën 2.3.1 të kriterëve të veçanta për kualifikim, kapaciteti teknik të shtojca 8, të DST-së dhe pretendimet vlerësohen të drejta. Në përfundim të shqyrtimit të ankesës së operatorit ekonomik ankimues “TETRA” SHPK në mbështetje dhe zbatim të pikës 3/a të nenit 114, të ligjit nr 162/2020 dhe pika 1/a të nenit 102

të VKM nr.285/2021, vendos pranimin e plotë të ankesës së operatorit ankimues “TETRA” SHPK duke e vlerësuar ofertë të rregullt.”

III.1.2. Neni 30 i LPP-së parashikon shprehimisht se: *Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesat e paraqitura para tij kur në mbledhje janë të pranishëm të paktën 3 nga 5 anëtarët e tij, një prej të cilëve kryetari ose nënkryetari. Në përfundim të shqyrtimit të ankesave, Komisioni vendos me shumicë votash. Vendimi deklarativ i dhënë sipas parashikimeve të nenit 115, pikat 2 dhe 3, të këtij ligji, jepet nga 3 anëtarë për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar dhe nga 5 anëtarët për procedurat e tjera.*

III.1.3. Neni 115 pikat 1 dhe 3 e ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik” i cili parashikon shprehimisht se: *Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesën e paraqitur, si dhe vendimin e autoritetit ose entit kontraktor, së bashku me dokumentet dhe shpjegimet shoqëruese, që mbështesin këtë vendim si më poshtë:*

a) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik vazhdon shqyrtimin:

i. për pjesën e ankesës/ pretendimeve që nuk janë pranuar;

ii. e ankesës/ ankesave për pjesën që është pranuar, nëse ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre për këtë pjesë në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

b) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin e plotë të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik do të vijojë shqyrtimin e ankesës, nëse ka ankesë nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

c) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur mos pranimin e ankesës.

3. Në rastin kur autoriteti ose enti kontraktor pranon plotësisht ankesën, Komisioni i Prokurimit Publik:

a) nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes brenda 3 ditëve nga marrja e vendimit të dhënë nga autoriteti ose enti kontraktor për këtë ankesë, nëse operatorët ekonomikë të interesuar nuk kanë paraqitur argumentet e tyre sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji;

b) nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes brenda 3 ditëve nga përfundimi i afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të nenit 114 të këtij ligji, nëse operatorët ekonomikë të interesuar, që kanë paraqitur argumentet sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji, nuk kanë ankimuar vendimin e dhënë nga autoriteti ose enti kontraktor.

III.1.4. Sa më sipër, nisur nga pretendimet e operatorit ekonomik ankimues, nga verifikimi i shkresës nr. 2182/8 prot., datë 07.12.2023, e dorëzuar pranë KPP-së në datë 11.12.2023, nga autoriteti kontraktor, konstatohet se ky i fundit, ka vendosur **pranim plotësisht të ankesës** së operatorit ekonomik ankimues, kështu që rrjedhimisht Komisioni do të mbyllë çështjen në lidhje me këto pretendime, për sa kohë ato janë pranuar nga vetë autoriteti kontraktor.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30 dhe 115, pikat 1 dhe 2 e ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për

ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendosi

1. Të mbyllë çështjen për ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “TETRA” SHPK, lidhur me procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur e thjeshtuar” me nr. REF – 86468-11-06-2023, me objekt: “Shërbim mirëmbajtje karikues elektrik, Marrëveshje kuadër për 2 vite”, me fond limit 9,000,000 (nëntë milion) lekë (pa TVSh), zhvilluar me datë 17.11.2023 nga autoriteti kontraktor, Posta Shqiptare Sh.A.
2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit të sipërcituar.
3. Ngarkohet zyra e financës, që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “TETRA” SHPK.
4. Kopje e këtij vendimi t’i dërgohet Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Kryetar
Jonaid Myzyri